



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 22, datë 20.11.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

“RESORT TURISTIK DHE REZIDENCIAL “SUN PLASË” ME OBJEKTE HOTELERIE
1-9 KATE MBI TOKË DHE 1-2 KATE NËNTOKË DHE OBJEKTE BANIMI 1-4 KATE
MBI TOKË DHE 1-2 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese “Golden Key” sh.p.k dhe “Sun Palas” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Resort turistik dhe rezidencial “Sun Plasë” me objekte hotelerie 1-9 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë dhe objekte banimi 1-4 kate mbi tokë dhe 1-2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Golden Key” sh.p.k dhe “Sun Palas” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim pas nënshkrimit nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/05/2025